

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6201
E shtunë, 26 dhjetor 2020
çmimi 0.40 €

Limaj: Sot zemra
e Kosovës është
në Hagë IFAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PREZANTOHET BOTIMI I GJASHTË I INDEKSIT TË PERFORMANCËS
SË INSTITUCIONEVE TË SUNDIMIT TË LIGJIT NË KOSOVË IFAQE 4-5

70 PËR QIND E QYTETARËVE BESOJNË SE POLITIKA TË BËN TË PAPREKSHËM NGA DREJTËSIA



Të premtën është prezantuar botimi i gjashtë i indeksit të performancës së institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë. Sipas këtij indeksi, 70 për qind e popullsisë beson se politika të bëjnë të paprekshëm nga drejtësia. Po ashtu, theksohet se 63.7 për qind e qytetarëve u besojnë më së paku gjykatave dhe prokurorive sepse mendojnë se kanë influencën më të madhe nga politika

OPINION

KUSH DO TË QEVERISË NË TË
ARDHMEN? F. 11

Bedri
ISLAMI



AKTUALE



TRUMPI I JEP MEDALJE
GRENELLIT PËR MARRËVESHJEN
KOSOVË - SERBI F. 5

HOXHAJ: PDK-JA DO T'I
VAZHDOJË POLITIKAT
KONSTRUKTIVE NË TË MIRË TË
SHTETIT DHE QYTETARËVE F. 5

NË MESHËN E KRISHTLINDJES, THIRRJE PËR PAQE DHE NDIHMË NDAJ NJËRI-TJETRIT



Në Katedralen "Nënë Tereza" në Prishtinë është mbajtur mesha e Krishtlindjes. Me këtë rast, Ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, në fjalimin e tij ka thënë se pan-

demia Covid-19 ka ndryshuar sjelljen tonë, mënyrën e komunikimit dhe jetën në përgjithësi. Ai është lutur për të gjithë ata që i kanë humbur më të dashurit e

tyre nga Covidi. Imzot Dodë Gjergji u ka bërë thirrje përfaqësuesve institucionale dhe politikë që ta rindërtojnë besimin e humbur mes njëri-tjetrit

DIALOGU NË PAUZË IFAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

EKONOMI

TË HËNËN, SEANCA E
JASHTËZAKONSHME PËR
VOTIMIN E BUXHETIT 2021 F. 9

3.6 MILIONË TURISTË MË PAK
NË SHOIPËRI GJATË PANDEMISË F. 9

SPORT

JAVË ME PLOT DERBI
NË BASKETBOLL F. 12

Papa u bën thirrje udhëheqësve të sigurojnë vaksina për të gjithë

ROMË, 25 DHJETOR - Papa Françesku u ka bërë thirrje udhëheqësve botërorë që të sigurojnë qasje të pakufizuar për të gjithë në vaksinat kundër koronavirusit. Në një fjalim të Ditës së Krishtlindjes, i mbajtur për herë të parë përmes internetit, Papa paralajmëroi kundër vendosjes së "mureve" në trajtimin e koronavirusit. Për shkak të pandemisë, mesazhi vjetor i Papës, "Urbi et Orbi" (për qytetin dhe botën), këtë vit nuk u mbajt nga ballkoni në Bazilikën e Shën Pjetrit. Në vend të kësaj Papa



foli nga një foltore në një dhomë brenda Vatikanit. Paralajmërimi i Papa Françeskut vjen mes shqetësimeve se vendet më të pasura po blejnë doza të vaksinave në mënyrë joproporcionale dhe në dëm të atyre më të varfërve. "Biri i Zotit të ripërtërijë te udhëheqësit politikë dhe të qeverive një frymë bashkëpunimi ndërkombëtar, duke filluar me kujdesin shëndetësor, në mënyrë që të gjithë të kenë qasje në vaksina dhe trajtim. Përballë një sfide që nuk njih

kufij, ne nuk mund të ngremë mure. Të gjithë jemi në të njëjtën varkë", ka thënë Papa. Ai ka shtuar se efektet e krizës shëndetësore treguan se nevoja për unitet global ishte më e madhe se kurrë. "Në këtë moment të historisë, të shënuar nga kriza ekologjike dhe çrregullimet e rënda ekonomike dhe shoqërore, të cilat pandemia vetëm sa i ka përkeqësuar, është edhe më e rëndësishme për ne ta njohim njëri-tjetrin si vëllezër dhe motra", ka deklaruar Papa Françesku.

Mjeku gjerman: Vaksina nuk e kthen normalitetin para verës

BERLIN, 25 DHJETOR - Derisa imunizimi kundër koronavirusit pritet të nisë këtë të diel në vendet e Bashkimit Evropian, doktori Tobias Welte nga Qendra gjermane për Sëmundje Infektive nuk është optimist se normaliteti do të kthehet përpara verës. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Welte thotë se vaksina Pfizer/BioNTech është e sigurt

dhe parandalon sëmundjen e rëndë nga koronavirusi, por ai paralajmëron se jo gjithçka është "bardh e zi" dhe se efektet afatgjata të vaksinës duhet të monitorohen. Welte porositi ata që kundërshtojnë vaksinimin se parandalimi i përhapjes së koronavirusit "është përgjegjësi sociale". "Ne e dimë se vaksina është efektive për ta parandaluar sëmundjen e

rëndë, por nuk e dimë nëse është efektive për ndalimin e transmetimit të virusit. Mund të ndodhë që nuk jeni të sëmurë, por të jeni infektues. Kjo është diçka që duhet të zbulohet. Andaj, duhet t'i vazhdojmë masat mbrojtëse: maskën dhe distancën. Jam i sigurt që nuk do t'i kthehem normalitetit deri në verë, por mund të jetë edhe më vonë", ka thënë ai.



Zjarrfikësit të veshur si babagjysha gëzojnë me dhurata fëmijët në spital

BOGOTA, 25 DHJETOR - Një ngjarje e pazakontë ka ndodhur në kryeqytetin e Kolumbisë, Bogota. Punonjësit e njësisë zjarrfikëse në kryeqytet, duke u veshur me kostume të babagjyshit, kanë vizituar spitalin "Simon Bolívar" dhe iu kanë shpërndarë dhurata fëmijëve që trajto-

hen këtu. Në aktivitetin social që u zhvillua në prag të Krishtlindjeve, dhuratat iu dorëzuan fëmijëve përmes shkallëve të zjarrfikëse. Fëmijët nga dritaret e dhomave të tyre e ndoqën me gëzim dhe emocione aktivitetin e shpërndarjes së dhuratave.

Portugalia heton 'masakrën' e 540 kafshëve të egra

LISBONË, 25 DHJETOR - Portugalia ka hapur hetime lidhur me vrasjen masive të 540 kafshëve të egra, kryesisht drerë dhe derra të egër, që mendohet të jenë kryer nga gjuetarë spanjollë. Nënkryetari i bashkisë Azambuja, i Qarkut të Lisbonës ku ndodhi gjuetia, tha për transmetuesin portugez TVI24

se kafshët ishin në një zonë të rrethuar dhe nuk kishin "ku të iknin". "Ajo që ndodhi ishte një masakër", tha Silvino Lúcio. Një grup spanjollësh që paguan më shumë se 8.000 euro (9.745 dollarë) secili për të gjuajtur në zonë më 17 dhe 18 dhjetor mendohet se qëndrojnë prapa masakrës masive.



Një tërmet 6.3 ballë godet Filipinet

MANILA, 25 DHJETOR - Një tërmet me fuqi prej 6.3 ballësh të premtën në mëngjes ka goditur ishullin Luzon pranë kryeqytetit

Manila të Filipineve. Instituti Filipinas i Vullkanologjisë dhe Sizmologjisë ka njoftuar se tërmeti ndodhi 74 kilometra

nën sipërfaqe dhe epiqendra e tij ishte në rajonin Calatagan, i vendosur në jugperëndim të Luzonit. Autoritetet në këtë shtet

paralajmëruan për lëkundje të tjera, por nuk lëshuan alarm për cunami. Nuk ka raportime për viktima apo dëme materiale.

Dialogu në pauzë

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Qeveria në detyrë e Kosovës ende nuk ka sjellë ndonjë vendim lidhur me atë se a do të vazhdojë ose jo dialogu me Serbinë në Bruksel, derisa vendi është në procesin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare.

Bashkimi Evropian nuk ka dhënë ndonjë përgjigje nëse zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare mund të ndikojnë në rrjedhën e dialogut në të mes Kosovës dhe Serbisë. Njohësit e zhvillimeve politike, Imer Mushkolaj dhe Armend Muja, konsiderojnë se derisa të mos përfundojnë zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare dhe të formohen legjislatura dhe qeveria e re, Kosova nuk duhet ta vazhdojë dialogun në Bruksel.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës më 21 dhjetor e ka shpallur të pavlefshëm votimin e Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga Avdullah Hoti nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Kjo qeveri ishte votuar, më 3 qershor, nga 61 deputetë. Gjykata ka dhënë arsyetimin duke thënë se vota e deputetit Etem Arifi, i dënuar me burgim prej një vit e tre muaj, ishte përcaktuese për qeverinë. Gjykata kërkoi shpalljen e zgjedhjeve të reja.

Ushtuesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, tashmë ka zhvilluar diskutimet me partitë politike, për ta caktuar datën e mbajtjes së zgjedhjeve, të cilat duhet të

mbahen jo më vonë se 40 ditë nga dita e shpalljes së tyre.

Analisti Imer Mushkolaj thotë për "Radion Evropa e Lirë", se pavarësisht që Beogradi mund të jetë i gatshëm që ta vazhdojë dialogun, kjo do të jetë e pamundur në këtë fazë. Ai shpreh mendimin edhe pas mbajtjes së zgjedhjeve, Kosova pritet të ballafaqohet me problemin e zvarritjes së krijimit të përbërjeve të institucioneve të reja.

Marrë parasysh këto, Mushkolaj nuk beson që të ketë vazhdim serioz të dialogut deri kah mesi i vitit të ardhshëm. "Çdo përpjekje edhe nga ana e qeverisë (në detyrë) apo kujtdo qoftë, që të krijojë përshtypje se kinse po vazhdon dialogu dhe kinse jemi në një situatë ku nuk ka ndodhur asgjë në raport me dialogun, është e gabueshme dhe nuk duhet të ndodhë. Më e mira e mundshme do të ishte që qeveria (në detyrë), për shkak të situatës së re të krijuar, t'ia bëjë të qartë ndërmjetësuesit, në këtë rast BE-së, që nuk është në gjendje që ta vazhdojë dialogun dhe se përpara dialogut ka çështje të tjera shumë më të rëndësishme që t'i zgjidhë", ka theksuar Mushkolaj.

Mendim të ngjashëm ka edhe analisti Armend Muja. Ai thotë për "Radion Evropa e Lirë" se deri në legjitimitimin e ri të institucioneve, zgjedhjes së kryeministrit të ri, por edhe presidentit të ri të vendit,



Kosova duhet të merret më shumë me vetveten sesa me dialogun. Për më shumë, sipas tij, përveç faktit që po hyn në proces zgjedhor, Kosova duhet të presë edhe të sqarohen parakushtet edhe në nivel ndërkombëtar. "Sa i përket dialogut në këtë fazë, unë nuk shoh parakushte as në nivel ndërkombëtar dhe as në nivelin ndërmjet shteteve dhe as brenda shoqërive përkatëse. Mendoj se (paraprakisht) janë rikonsolidimi i administratës së (presidentit të zgjedhur të ShBA-së, Joe) Biden, pastaj njësimi i pozicioneve të ShBA-së dhe BE-së, të cilat janë shumë të rëndësishme dhe vetëm atëherë mund të shpresohet për një përaftrim ndërmjet vendeve", ka theksuar Muja.

Zyrtarë të delegacionit të Kosovës për dialogun me Serbinë i kanë thënë "Radios Evropa e Lirë" se ende nuk kanë ndonjë përgjigje nëse dialogu do të vazhdojë ose jo derisa të

kryhet procesi zgjedhor. "Nuk ka ndonjë vendim. Priten vendimet lidhur me këtë çështje", kanë thënë nga delegacioni i deritashëm i Kosovës për dialogun me Serbinë.

Në Bashkimin Evropian nuk kanë dashur të përgjigjen në pyetjet se a presin që zhvillimet në Kosovë, të cilat tashmë kanë dërguar vendin në zgjedhje të parakohshme parlamentare, të ndikojnë në rrjedhën e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, të cilin është duke e lehtësuar Bashkimi Evropian.

Ata kanë përsëritur që BE-ja do të vazhdojë të jetë e angazhuar me bashkëbiseduesit në Kosovë dhe Serbi, në kuadër të dialogut dhe se ai dialog është i rëndësishëm për rrugën përkatëse evropiane. Gjithashtu, nga BE-ja kanë përsëritur thirrjet ndaj Kosovës që t'i respektojë dhe zbatojë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tash në dialog.

Njohësit e zhvillimeve politike,

megjithatë nuk presin që BE-ja t'i bëjë presion Kosovës gjatë kohës sa ajo është në proces zgjedhor dhe më pas në rikrijimin e përbërjes së institucioneve më të larta të saj.

Analisti Mushkolaj thekson që në rast se Brukseli organizon takime të reja ndërmjet palëve të Kosovës dhe Serbisë, vetëm sa për ta mbajtur gjallë dialogun, kjo nuk do t'i kontribuonte qëllimit kryesor të dialogut, që është arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ndërmjet palëve. "Kështu që çdo përpjekje, nga kushdo qoftë, në këtë rast edhe nga Brukseli si ndërmjetësues për të organizuar raunde të reja të dialogut, në situatën ekzistuese janë të kota dhe nuk duhet të ndodhin. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe pas shpalljes së zgjedhjeve, kurdo që kjo të ndodhë nga ana e ushtreses së detyrës së presidentit, qeveria nuk e ka më legjitimitetin e duhur për ta vazhduar dialogun", ka theksuar Mushkolaj.

Por, analisti Muja vlerëson se Bashkimi Evropian nuk do të insistojë që dialogu në Bruksel të vazhdojë edhe gjatë kohës që Kosova është në proces zgjedhor. "Bashkimi Evropian e di shumë mirë që dialogu në nivel të ekspertëve, ndonëse ka pasur përparime, ato prapë kanë ngecur te vullneti politik. Pa vullnet politik unë nuk shoh asnjë formë se si mund të ketë dialog teknik", është shprehur Muja.

Limaj: Sot zemra e Kosovës është në Hagë

MALISHEVË, 25 DHJETOR (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se Kosova asnjëherë nuk i ka pasur punët më keq. Limaj gjatë një takimi me strukturat e Nismës në Malishevë ka kërkuar të premtën mobilizimin e qytetarëve për ta nxjerrë vendin nga udhëkryqi në të cilin gjendet. Në këtë kontekst, Limaj ka thënë se para tri vjetësh kishte paralajmëruar se vendi do të vijë pikërisht në këtë udhëkryq.

Limaj ka folur edhe për ish-bashkëluftëtarët të cilët gjenden në Hagë duke u përballur me Gjykatën Speciale. Duke iu referuar Jakup Krasniqit, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe të tjerëve, Limaj ka thënë se sot zemra e Kosovës është në Hagë. "Sot disa individë që nuk kanë bërë asgjë për vendin, po thonë se na jemi siguria për vendin. Si mund të jenë ata kur nuk kanë bërë gjë për këtë vend. Disa po e



kontestojnë krejt atë që është arritur në këto 20 vjet. Sot zemra e Kosovës është në Hagë. Ata

janë atje për vitet '98-99, por ata më kanë prapa mua 24 orë. Do t'i rri prapa dhe do t'i mbështes me

krejt qënien time. Zërin e lirisë së Kosovës, Jakup Krasniqin, e kemi në Hagë për, gjoja, krime lufte,

prandaj betejën do ta bëjmë për Kosovën dhe ky do të jetë angazhimi ynë", ka thënë Limaj.



PREZANTOHET BOTIMI I GJASHTË I INDEKSIT TË PERFORMANCËS
SË INSTITUCIONEVE TË SUNDIMIT TË LIGJIT NË KOSOVË

70 PËR QIND E QYTETARËVE BESOJNË SE POLITIKA TË BËN TË PAPREKSHËM NGA DREJTËSIA

Të premtën është prezantuar botimi i gjashtë i indeksit të performancës së institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë. Sipas këtij indeksi, 70 për qind e popullsisë beson se politika të bën të paprekshëm nga drejtësia. Po ashtu, theksohet se 63.7 për qind e qytetarëve u besojnë më së paku gjykatave dhe prokurorive sepse mendojnë se kanë influencën më të madhe nga politika

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Drejtësia Sot, platformë e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), ka organizuar të premtën konferencën për media në të cilën janë shpalosur të gjeturat e botimit të gjashtë të "Indeksit të performancës së institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë, i njohur me emrin RoLPIK". Kjo konferencë u titullua "Sfidat në sundimin e ligjit në Kosovë: Performanca e sistemit gjyqësor dhe

prokurorial dhe vlerësimi qytetar ndaj këtyre institucioneve", për arsye se edhe edicioni i gjashtë i RoLPIK është bazuar në të dhënat e perceptimit qytetar mbi punën e institucioneve zbatuese të ligjit, në raportet vjetore të Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor të Kosovës dhe në Ligjin për Buxhetin, duke bërë krahasime përgjatë viteve 2013-2019.

Nga të dhënat e RoLPIK, Drejtësia Sot ka vërejtur që përkundër agjendës "Drejtësia 2020" dhe procesit të rishikimit funksional, që të

dyja të nisura nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim kryesor sigurimin e mbarëvajtjes dhe rikthimin e besimit të qytetarëve në drejtësi. Më shumë se gjysma e qytetarëve mendojnë se kanë vërejtur përmirësim në sistemin e drejtësisë, ndërsa vetëm 30.7 për qind e qytetarëve mendojnë se ka efekte pozitive në këtë aspekt. Drejtësia Sot, përmes edicionit të gjashtë të RoLPIK, ka ofruar të dhëna sipas ndarjes së indikatorëve: në perceptimin qytetar dhe në performancën e sistemit të drejtësisë. Perceptimi qytetar

mbi institucionet e drejtësisë ndër vite është trajtuar nga RoLPIK përmes indikatorëve si ndikimi politik, mitmarrja, raportimi dhe efektiviteti në luftën kundër korrupsionit, ndërsa performanca e sistemit të drejtësisë është trajtuar në bazë të efikasitetit, shkallës së mbipopullimit, ngarkesës së sistemit të drejtësisë dhe alokimeve buxhetore.

Drejtësia Sot ka gjetur se sa i përket ndikimit politik në institucionet e drejtësisë, për vitin 2020, rreth 68.5 për qind e qytetarëve besojnë se politikanët kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji, kurse vetëm 21.4 për qind prej tyre mendojnë se qytetarët janë të barabartë para drejtësisë, duke bërë që përafërsisht 70 për qind e popullsisë besojnë se politika të bën të paprekshëm nga drejtësia. Sipas të dhënave të raportit,

63.7 për qind e qytetarëve u besojnë më së paku gjykatave dhe prokurorive sepse mendojnë se kanë influencën më të madhe nga politika. Ndërsa institucionet me influencën më të vogël politike i konsiderojnë Policinë e Kosovës me 20.3 për qind dhe EULEX-in me 13.9 për qind. Sa i përket mitmarrjes, RoLPIK ka vënë në pah se 48.1 për qind e të anketuarve, besojnë se institucionet e drejtësisë vazhdojnë të jenë të prekura nga kjo dukuri. Pavarësisht se në krahasim me vitin paraprak përqindja është ulur për 0.5 për qind, perceptimi negativ mbetet mendim i shumicës. Institucionet më të prekura nga kjo dukuri, sipas 59.5 për qind e qytetarëve, janë gjykatat dhe prokuroria që, në krahasim me vitin e kaluar, ka ulje të trendit për 4.7 për qind.

Hoxhaj: PDK-ja do t'i vazhdojë politikat konstruktive në të mirë të shtetit dhe qytetarëve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, i shoqëruar edhe nga sekretari Uran Ismaili dhe anëtari i Kryesisë së PDK-së, Bedri Hamza, kanë pritur të premten në takim përfaqësuesit e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, Odës së Mjekëve dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës. Kryetari i FSSHK-së, Blerim Sylja, kryetari i Odës së Mjekëve, Pleurat Sejdiu dhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, kanë përgëzuar kryetarin në detyrë, Enver Hoxhaj dhe Partinë Demokratike të Kosovës, për konstruktivitetin politik, siç

ishte rasti i fundit me votimin e pakos së rimëkëmbjes ekonomike.

Në këtë takim të gjithë njëzëri kërkuan nga kryetari Hoxhaj që t'i vazhdojë politikat në të mirë të qytetarëve dhe shtetit edhe në proceset e tjera në vazhdim siç është votimi i buxhetit.

Kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka falënderuar udhëheqësit e këtyre sindikatave dhe odave për vizitën dhe bashkëpunimin e tyre profesional që kanë pasur gjithmonë me PDK-në. Me këtë rast, kryetari Hoxhaj ka thënë se Partia Demokratike e Kosovës, ashtu siç ka dëshmuar historikisht, do t'i vazhdojë edhe më tej politikat konstruktive në të mirë të shtetit dhe qytetarëve.



Edhe tetë viktima dhe 249 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 25 DHJETOR (ER) - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 048 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 249 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar tetë raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.



Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prishtinë dy raste (77, 68 vjeç), Fushë-Kosovë një rast (62 vjeç), Gjilan një rast (83 vjeç), Mitrovicë një rast (73 vjeç), Pejë një rast (68 vjeç), Skenderaj një rast (77 vjeç) dhe Vushtrri një rast (76 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 50 135 raste nga 177 387 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 298 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 538 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 38.656 raste, ndërsa

numri i rasteve aktive është 10 181. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 99 raste, Gjakovë 14 raste, Gjilan 14 raste, Graçanicë 14 raste, Drenas 13 raste, Ferizaj 12 raste, Fushë-Kosovë 12 raste, Mitrovicë 12 raste, Podujevë 10 raste, Lipjan 7 raste, Prizren 7 raste, Obiliq 4 raste, Deçan 3 raste, Pejë 3 raste, Rahovec 3 raste, Skenderaj 3 raste, Suharekë 3 raste, Viti 3 raste, Vushtrri 3 raste, Dragash 2 raste, Istog 2 raste, Junik 2 raste, Klinë 2 raste dhe me nga një rast komunat Novobërdë dhe Shtërpçë.

Trumpi, medalje Grenellit për marrëveshjen Kosovë - Serbi

Prishtinë, 25 dhjetor (ER) - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, e ka dekoruar të dërguarin e posaçëm për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, me "Medaljen e Sigurisë Kombëtare". "Ambasadori Richard Grenell është nderuar për kontributin e tij të jashtëzakonshëm që mundësoi nënshkrimin historik të normalizimit të marrëdhënieve ekonomike midis Serbisë dhe Kosovës. Sipas kësaj marrëveshjeje, Serbia dhe Kosova rivendosën lidhjet e drejtpërdrejta ajrore, hekurudhore dhe autostradën, projektet kryesore të infrastrukturës të nevojshme për ta lehtësuar rritjen ekonomike dhe transferimin në kohë të mallrave dhe njerëzve", ka thënë Trump në vendimin e tij. Njoftimin e ka bërë publik

ambasadori Grenell përmes një postimi në rrjetin social "Instagram". "Kjo marrëveshje është një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të një Evrope më paqësore, të sigurt dhe më të prosperuar. Kontributet e ambasadorit Grenell për arritjen e këtij përparimi historik diplomatik në Serbi dhe Kosovë do të çojnë në një të ardhme më të ndritur për miliona njerëz", është thënë në vendim.

Grenelli u emërua i dërguar i posaçëm për dialogun Kosovë - Serbi në tetor të vitit 2019, derisa po shërbente ambasador i Shteteve të Bashkuara në Gjermani.

Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar më 4 shtator, në Uashington, dy dokumente për normalizimin e raporteve ekonomike, në prani të presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump.



Komuna e Malishevës kërkon nga KOSTT-i të marrë masa për furnizim me energji elektrike

MALISHEVË, 25 DHJETOR (ER) - Kuvendi i Komunës së Malishevës ka miratuar një kërkesë urgjente drejtuar KOSTT-it, për përmirësimin e furnizimit me energji elektrike për Komunën e Malishevës, pasi kohën e fundit Malisheva është duke u përballuar me reduktime të ashpra të rrymës dhe me furnizim jashtë çdo standardi. Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës

unanimisht e kanë miratuar këtë kërkesë në adresë të KOSTT-it. "Komuna e Malishevës dhe qytetarët e saj ka dhjetë ditë që janë duke u ballafaquar me reduktime të ashpra me energji elektrike për shkak të ngarkesës në rrjetin elektrik. Nga këto reduktime dhe rryma e cila po u shërbehet qytetarëve tanë është nën çdo standard të lejuar për ekonominë familjare

dhe ato pak biznese prodhuese që operojnë në komunën tonë. Ne deri më tani nuk kemi parë as përpjekjen më të vogël që kjo gjendje të përmirësohet nga ana e kompanive përgjegjëse. Gjendja nëpër të cilën po kalojmë ta kujton kohën e luftës sa i përket furnizimit me energji elektrike", është thënë në njoftimin e Komunës së Malishevës.



Bekim Jashari shpalos para qytetarëve punën njëvjeçare

SKENDERAJ, 25 DHJETOR (ER) - Është mbajtur takimi i dytë publik me qytetarët i kryetarit të Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, në të cilin është prezantuar puna njëvjeçare e qeverisjes komunale të tij.

Kryetari Jashari para të pranishmëve në sallën e Kulturës "Hasan Prishtina" ka njoftuar për projektet që janë realizuar brenda këtij viti në çdo pjesë të komunës si dhe ato që janë në realizim e sipër dhe që priten të përfundojnë së shpejti.

Ai ka theksuar se pa marrë parasysh shumë sfida që i ka krijuar pandemia Covid-19, brenda këtij viti janë arritur të zgjidhen shumë probleme të cilat janë jetike për qytetarët e Skenderajt, duke theksuar këtu ujin e pijshëm. "11 fshatra të Skenderajt këtë vit janë bërë me ujë të pijshëm, kurse dhjetë fshatra të tjera bëhen me ujë të pijshëm vitin që vjen", ka thënë ai.

Jashari në këtë takim me qytetarët ka theksuar edhe një herë se komuna që ai udhëheq i ka dhënë prioritet të veçantë zhvillimit të bujqësisë, duke



pesëfishuar buxhetin për këtë fushë nga 48 mijë sa ishte i planifikuar për vitin 2018, në 217 mijë e 730 euro këtë vit, bashkë me ndihmën e donatorëve. "Vetëm brenda vitit 2020 bashkë me donatorët kemi përkrahur afër 500

fermerë në komunën tonë, me vlerë totale buxhetore prej afër 400 mijë euro", është shprehur kryetari Jashari.

I pari i komunës ka thënë se vëmendje e madhe i është kushtuar ndihmës së familjeve në nevojë për shkak të

pasojave që ka shkaktuar pandemia globale Covid-19. Ai ka treguar se të rinjtë e kësaj komune, studentët, janë përkrahur me bursa, ku nga buxheti i komunës janë dhuruar 170 bursa si dhe 27 të tjera nga donatorët.

Kryetari Jashari ka përmendur edhe dhjetëra shkolla të cilat janë përruar si dhe janë rinovuar. Po ashtu, ai ka theksuar se Komuna e Skenderajt ka shërbyer si model për komunat e tjera për mbajtjen e premtimit për shujta për mësimdhënësit, ku gjatë këtij viti u ndan 800 mijë euro për mësimdhënësit si dhe punëtorët teknikë. Fokus të veçantë Jashari tha se i ka dhënë edhe mjedisit, duke bërë kështu largimin e deponive ilegale në zona urbane dhe rurale.

Ai ka pohuar se përpjekja për krijimin e një infrastrukture moderne është duke vazhduar në këtë komunë. Sipas tij, vetëm brenda këtij viti janë asfaltuar 41 kilometra e 659 metra rrugë si dhe është rregulluar sistemi i kanalizimit me gjatësi mbi 85 kilometra. Në këtë takim Jashari përmendi edhe shumë projekte të fushës së kulturës të cilat kanë përfunduar në mënyrë të suksesshme si dhe ka premtuar se përkrahja e tij për këtë fushë nuk do të mungojë as në të ardhmen.

Komuna e Gjilanit largon deponinë në lagjen "Iliria"



GJILAN, 25 DHJETOR (ER) - Për të katërtën herë gjatë këtij viti Komuna e Gjilanit ka larguar deponinë e egër në lagjen "Iliria".

Nënkryetari i komunës, Arbër Ismajli, ka njoftuar për masa rigoroze ndaj të gjithë atyre që

e ndotin ambientin, siç është rasti në këtë lagje në zemër të qytetit. "Të gjithë ata që e shëmtojnë qytetin dhe e ndotin ambientin, sapo hasen nga zyrtarët e Inspeksionit, do të gjobiten sipas ligjeve në fuqi dhe lënda do të drejtohet në

organet e shtetit për procedim", ka thënë Ismajli, i cili u ka bërë thirrje qytetarëve që të mos e ndotin ambientin duke hedhur mbeturina vend e pa vend. Komuna e Gjilanit për gjashtë muaj të këtij viti ka shpallur aksion të pastrimit të qytetit.

Bulliqi i bashkohet aksionit për dhurimin e gjakut

PODUJEVË, 25 DHJETOR (ER) - Për nder të shënimit të 22-vjetorit të Betejës së Tabeve të Llapashticës dhe të rënëve në këtë betejë,

Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin Gjakut në ambientet e restorantit "Artela" në Llapashticë ka organizuar

aksion të dhurimit vullnetar të gjakut. Këtij aksioni i është bashkangjitur edhe kryetari i Komunës së Podujevës,

Shpejtim Bulliqi, duke dhuruar gjak, deputeti i Kuvendit të Kosovës, Fitim Haziri dhe qytetarë të tjerë të Komunës së Podujevës.



Në meshën e Krishtlindjes, thirrje për paqe dhe ndihmë ndaj njëri-tjetrit

Në Katedralen “Nënë Tereza” në Prishtinë është mbajtur mesha e Krishtlindjes. Me këtë rast, Ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, në fjalimin e tij tha se pandemia Covid-19 ka ndryshuar sjelljen tonë, mënyrën e komunikimit dhe jetën në përgjithësi. Ai është lutur për të gjithë ata që i kanë humbur më të dashurit e tyre nga Covidi. Imzot Dodë Gjergji u ka bërë thirrje përfaqësuesve institucionale dhe politike që ta rindërtojnë besimin e humbur mes njëri-tjetrit

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Në Katedralen “Nënë Tereza” në Prishtinë është mbajtur mesha e Krishtlindjes, e cila është udhëhequr nga Ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, i cili ka thënë se pandemia e ka ndryshuar sjelljen tonë, mënyrën e komunikimit dhe jetën në përgjithësi.

“Pavarësisht kësaj, kremtimi këtë vit do të jetë më i bukur, pasi do të festojmë më me përshpirtëri, do të jemi më të aftë për ta ndier praninë e Zotit”, ka thënë Dodë Gjergji. Ai tha se lutet për të gjithë ata që i kanë humbur më të dashurit nga Covid-19. “Nëpërmjet lutjeve të mia jam munduar të marr pjesë në dhimbjen e atyre që kanë humbur më të dashurit, në

vuajtjen e atyre që janë përballur ose janë duke u përballuar me pasojat e infektimit dhe për gjithë ato gra e burra që si mjekë, infermierë ose në ndonjë përgjegjësi tjetër janë duke u lodhur, sikur thotë populli, deri në pikën e fundit vetëm që të shpëtojnë jetët e njerëzve. Sigurisht, pa i përjashtuar të tjerët për të cilët kisha lutet vazhdimisht: ata që vuajnë nga sëmundjet e tjera e që përballen me padrejtësitë e botës siç janë: emigrantët, të varurit, të harruarit e të marginalizuarit”, ka thënë Dodë Gjergji.

Ai ka ftuar përgjegjësit institucionale dhe politike që ta rindërtojnë besimin e humbur mes njëri-tjetrit. “Në këto fjali shprese të Shkrimit të Shenjtë i ftoj edhe përgjegjësit institucionale dhe politike në vend që ta rigjejnë urtinë e të parëve, entuziazmin e dikurshëm për liri dhe vullnetin që kishim për paqen, për ta rindërtuar besimin dhe për të gjetur paqen e brendshme, pasi paqja, pajtimi dhe besimi në

njëri-tjetrin nuk është vetëm nevojë e përkohshme e as nuk i takon vetëm një gjenerate, por përgjegjësi e vazhdueshme e secilit prej nesh, që e dëshiron vetë Zoti”, ka pohuar Ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji. Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës kanë uruar besimtarët katolikë për festën e Krishtlindjes, duke theksuar unitetin e popullit të Kosovës në shënimin e festave fetare dhe bashkëpunimin ndërfaqësor. Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se në këtë kohë kur bota po përballlet me pandeminë e Covid-19 “duhet të mendojmë për të gjithë ata që janë në vështirësi”. Në urimin e saj për festën e Krishtlindjes, Osmani ka bërë thirrje që t’u “zgjatet dora atyre që janë në nevojë, dhe ta ngjallim shpresën për një të ardhme më të mirë”. “Festat fetare te populli ynë gjithëherë na kanë bashkuar. Si çdo vit, edhe sivjet të festojmë bashkë, të jemi solidarë dhe të reflektojmë harmoni”, thuhet në urimin e

Osmanit.

Ndërsa kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka thënë në urimin e tij se “tradita dymijëvjeçare e krishtëritimit ndër shqiptarë është faktor përcaktues në karakterin tonë unik kulturor dhe shpirtëror”. “Ne jemi shembull i mirëkuptimit dhe harmonisë në diversitetet. Historia na ka përcaktuar që ne të kemi besime të ndryshme, por kjo asnjëherë nuk na ka penguar që ta duam më shumë njëri-tjetrin dhe t’i kremtojmë bashkë të gjitha festat tona”, ka thënë Hoti përmes një video mesazhi të publikuar në llogarinë e vet në “Facebook”.

Për festën e Krishtlindjes kanë uruar edhe përfaqësues të spektrit politik, ndërsa në urimin e myftiut të Kosovës, Naim Tërnavë, drejtuar Ipeshkvit të Ipeshkvit të Kosovës, Dodë Gjergji, thuhet: “Festat fetare te ne si gjithëherë, edhe në këtë rast, paraqesin momentin e ndërgjegjësimit për bashkim, respekt, dashuri dhe solidaritet”.



Arrestohen katër persona për posedim të narkotikëve dhe armëmbajtje pa leje

PRISHTINË, 25 DHJETOR (ER) - Policia e Kosovës, bazuar në objektivat strategjike dhe planifikimet operacionale për garantimin e rendit dhe sigurisë publike, si dhe parandalimin e krimit, Njësia për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve në Prishtinë, më 24 dhjetor, pas një pune hetimore, ka arritur t’i arrestojë katër persona të dyshuar për përfshirje në veprat penale “Blerja, posedimi shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll

ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Njësi policor fillimisht kishte arritur t’i arrestojë tre personat e dyshuar, të cilët dyshohet se ishin ndaluar në një parking të magjistrales Mitrovicë - Prishtinë për ta kryer blerjen, gjejësisht shitjen e substancave narkotike.

Gjatë kontrollimit tek i dyshuari (E. M., viti 1993) janë gjetur dhjetë gramë kokainë dhe një qese me marijuanë, të cilat dyshohet se i kishte blerë nga i dyshuari (M. K., viti 1974), kurse te ky i fundit janë gjetur një qese e vogël me kokainë



dhe paratë e përdorura në shitblerje. “Si vazhdimësi e hetimeve, me urdhëresë të organeve të drejtësisë, janë bërë bastisjet e shtëpive të dy personave të dyshuar (M. K. në Gjakovë) dhe një të dyshuari të tretë (B. R. në Orlovicë). Për bastisjet e kryera në Gjakovë është njoftuar edhe prokurori i krimeve të rënda”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Personat e dyshuar, tanimë të arrestuar, pas intervistimit, me urdhër të Prokurorisë Themelore - Departamenti i Krimeve të Rënda, janë dërguar në qendrën e ndalimit.

Të hënën seanca e jashtëzakonshme për votimin e buxhetit 2021



Prishtinë, 25 dhjetor (ER) - Deputetët e Kuvendit të Kosovës do të bëjnë përpjekje të hënën ta miratojnë buxhetin për vitin 2021. Lajmin e ka bërë me dije shefi i grupit parlamentar i

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi. “Me kërkesë të mbi 40 deputetëve nënkruar, ditën e hënë në orën 11:00 mbahet seanca e jashtëzakonshme për

aprovimin e Ligjit për ndarjet buxhetore, po ashtu në rend dite është edhe miratimi i marrëveshjeve ndërkombëtare që janë në procedurë, pastaj shkojmë në zgjedhje”, ka

shkruar Gashi në llogarinë e vet në “Facebook”.

Pas vendimit të Gjykatës Kushtuese për pavlefshmërinë e votës së deputetit Ethem Arifi për zgjedhjen e qeverisë Hoti

dhe dërgimin e vendit në zgjedhje të reja, partitë parlamentare, me përjashtim të LV-së, kanë shprehur gatishmërinë ta miratojnë buxhetin për vitin 2021.

Nëse nuk votohet buxheti i 2021-s nuk do të ketë paga

Ish-deputeti i Partisë Socialdemokrate të Kosovës, Dardan Sejdiu, ka thënë se nëse nuk votohet buxheti i vitit 2021, ka mundësi që i gjithë sistemi i financave shtetërore të jetë jofunksional. Sejdiu përmes një postimi në “Facebook” ka shkruar se nëse nuk votohet buxheti, nuk do të ketë paga dhe pagesat bizneseve për punët publike

si dhe transferet sociale do të ndalen. “Dmth., nëse nuk votohet buxheti i vitit 2021, mundësi reale ka që i gjithë sistemi i financave shtetërore të jetë jofunksional. Pra, paga nuk do të ketë, pagesa bizneseve për punët publike nuk do të bëhen, transferet sociale do të ndalen. Kësaj mund t’i themi, sërish vjen marsi”, ka shkruar Sejdiu.

3.6 milionë turistë më pak në Shqipëri gjatë pandemisë

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

TIRANË, 25 DHJETOR - Kufizimi i lëvizjeve për shkak të pandemisë ka ndikuar ndjeshëm në hyrjen e shtetasve të huaj dhe daljen e shqiptarëve, duke ndikuar sidomos negativisht turizmin në vend. Sipas Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në Shqipëri në 11-mujorin e 2020-s është 2.477.003, duke rënë në 59,5 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019. “Në total janë 3.64 milionë shtetas të huaj më pak në krahasim me 11-mujorin 2019-s”, thuhet në raport. Përgjatë njëmbëdhjetë muajve të vitit 2020, Kosova ka rënie më të ulët të hyrjeve të shtetasve në Shqipëri me 40,4 për qind, ndërsa rënie më të madhe e ka pasur Spanja me 90,7 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin nëntor 2020 janë 360.343. Krahasuar me nëntorin e 2019-s, ky tregues rezulton me rënie 48,1 për qind.

Në nëntor të vitit 2020 hyrjet e shtetasve të huaj në territorin shqiptar janë 148.362. Krahasuar me nëntorin e 2019-s, ky numër ka rënë 44,7 për qind.

Në nëntor edhe shtetasit nga Kosova kanë shënuar një rënie të lehtë, 5,9 për qind, ndryshe nga shtatori dhe tetori kur hyrjet e shtetasve nga Kosova njohën një rritje dyshifrore. Por rritje të fortë në nëntor shënuan shtetasit nga Maqedonia, që ishin 29 për qind më shumë se i njëjti muaj i një viti më parë.

Ndërsa kanë shënuar rënie të thellë hyrjet e shtetasve në nëntor nga Greqia (-89 për qind), pas problemeve e vonesave në kufirin grek, nga Italia (-72 për qind), nga Spanja (-93 për qind), nga Polonia (-82 për qind). Për shkak të rënies së lartë të hyrjes së shtetasve të huaj gjatë këtij viti nga kufizimet e pandemisë, është rritur pesha e turistëve nga Kosova. Për 11-mujorin 2020, hyrjet e shtetasve nga Kosova përbënin 52 për qind të totalit, nga 35 për qind që ishte kjo peshë për të njëjtën periudhë të një viti më parë.

2.7 milionë shqiptarë më pak udhëtuan jashtë

Edhe udhëtimet e shqiptarëve jashtë kanë qenë shumë të kufizuara, me 2.7 milionë shtetas nga Shqipëria që kanë dalë jashtë vendit për 11-mujorin, në krahasim me muajt janar-nëntor të 2019-s. Sipas INSTAT, daljet e shtetasve shqiptarë dhe të



huaj nga territori shqiptar, gjatë muajit nëntor 2020, janë 366.335 duke shënuar një rënie me 53,5 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë gjatë

muajit nëntor 2020-s janë 208.183. Krahasuar me nëntorin e vitit 2019, ky numër ka rënë 56,6 për qind. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit nëntor 2020 janë 158.152. Krahasuar me

nëntorin e vitit 2019, ky numër ka rënë 48,5 për qind. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga Shqipëria në 11-mujorin e 2020-s është 2.691.130 duke rënë 50,5 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Klubi i Prodhuesve kërkon nga ATK-ja ta bëjë vazhdimin e autorizimit për lirime në import në lëndë të parë

PRISHTINË, 25 DHJETOR (ER) - Klubi i Prodhuesve kërkon nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) që ta bëjë vazhdimin e vendimeve për autorizimin për lirime në import në lëndë të parë, i cili për disa kompani vlen deri në fund të vitit. Sipas KPK-së, disa kompanive prodhuese iu

skadojnë autorizimet më 31.12.2020 dhe këto të fundit nuk kanë bërë kërkesë për vazhdim sepse kanë menduar që të gjitha autorizimet janë vazhduar me automatizëm si pjesë e vendimeve qeveritare për masat kundër pandemisë Covid-19. "Duke marrë parasysh gjendjen aktuale të

kufizimeve të pandemisë, por edhe paqartësitë që kompanitë prodhuese po hasin lidhur me autorizimet për lirime në import dhe afatet kohore të këtyre autorizimeve, por edhe për t'i shmangur pengesat dhe mundësuar mbarëvajtjen e procesit të prodhimit, kërkojmë nga ATK-

ja vazhdimin e vendimeve të autorizimeve për lirime në import të lëndë të parë deri më 31.12.2021 ose, së paku, shtyrja e afatit të bëhet deri në mars 2021, për të krijuar hapësirë të mjaftueshme kohore për pajisje me autorizime të reja dhe për të mos penguar prodhuesit në

afarizmin e tyre gjatë kësaj periudhe. Andaj kërkojmë nga ATK-ja që vendimet për autorizimin për lirime në import të vazhdojnë me automatizëm deri në vitin e ardhshëm ose, së paku, të shtyhet afati deri në muajin mars të vitit 2021", thuhet në njoftimin e KPK-së.



KLUBI I PRODHUESVE TË KOSOVËS
KOSOVO MANUFACTURING CLUB



Qeveria nuk ia realizon kërkesat, Sindikata e sektorit privat angazhon avokat

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Punëtorët teknikë dhe ata të sigurimit tash e një kohë janë në grevë nëpër të gjitha institucionet shëndetësore në vend, duke kërkuar pagesë shtesë gjatë pandemisë nga qeveria. Se greva është duke vazhduar e ka konfirmuar edhe kreu i Sindikatës së sektorit privat, Jusuf Azemi, i cili ka treguar se punëtorët janë duke e respektuar grevën në përpikëri. "Punëtorët teknikë dhe ata të sigurimit po vazhdojnë grevën sipas vendimit që është marrë në kryesinë ekzekutive të sindikatave të pavarura të sektorit privat të Kosovës. Të gjithë punëtorët janë duke e respektuar grevën me



përpikëri", u shpreh Azemi.

Ai ka treguar se kanë pasur presion për ta ndërprerë

grevën. "Në ditët e para kemi pasur presion nga drejtorët e qendrave spitalore dhe të

qendrave të mjekësisë familjare, por me kalimin e kohës gjithçka është në nivel dhe nuk kemi ndonjë presion te punëtorët. Pronarët e kompanive janë duke bashkëpunuar jashtëzakonisht mirë me sindikatën dhe me punëtorët", ka thënë Azemi për "Ekonomia Online".

Ai ka deklaruar se pa marrë parasysh se ata janë pajtuar me kryeministrin Avdullah Hoti dhe zëvendëskryeministrin Driton Selmanaj se mjetet do t'u dalin këtyre punëtorëve, ende nuk ka diçka në këtë drejtim. "Që nga takimi i parë me ministrin e Shëndetësisë ne prapë jemi marrë vesh që kjo pagesë të fillojë menjëherë pas një

marrëveshje gojore. Deri më tani nuk kemi lëvizje", u shpreh Azemi.

Kreu i sindikatës ka njoftuar se tashmë të drejtat e punëtorëve do t'i kërkojnë përmes ligjit, ku edhe kanë angazhuar një avokat. "Planet tona janë në tri rrugë. Jemi të hapur për nënshkrimin e marrëveshjes sepse për bisedime nuk kemi çfarë të bisedojmë më, pra në raport me qeverinë apo Ministrinë e Shëndetësisë. Ndërkaq për kohën e festave mund të ndryshojmë diçka për rrjedhën e grevës dhe tani jemi në marrëveshje për angazhimin e një avokati që në mënyrë ligjore ta kërkojmë të drejtën tonë", ka përfunduar Azemi.



Bedri ISLAMI

Kush do të qeverisë në të ardhmen?

Më 25 prill Shqipëria do t'i ketë zgjedhjet e reja parlamentare, të shumëpritura nga opozita, të cilat do të jenë të rregullta, me Kodin e ri Zgjedhor dhe, për fat të keq, si gjithnjë, në klimën e mosbesimit të madh në mes të forcave politike, çka tani ka arritur një nivel nga majta e saj më të thikta. Njëra palë, më saktë, skifterët politikë të njëjës palë të opozitës, përfaqësuar nga Berisha dhe Meta, kanë kaq kohë që bëjnë thirrje për ta përmbysur qeverisjen e tashme, edhe përmes dhunës dhe, si deklaroi një ditë më parë Berisha, shefi i dikurshëm i presidencës dhe i qeverisë, më 22 dhjetor 2020, nëse nuk do të ketë fitore me votë, do të ketë luftë!!!

Meta, shefi i tanishëm i presidencës dhe ish-kryeministri i dikurshëm, po ashtu, pas mitingut të 2 marsit të vitit që shkoi, dhe ky ishte i pari miting në historinë 30-vjeçare të pluralizmit ku shefi i presidencës bën thirrje të hapur për ta përmbysur qeverinë, të ripërsëritur në çdo takim dhe duke thirrur në ndihmë figura historike si Vojo Kushi e Alende.

Nga ana tjetër, shefi i tashëm i shumicës dhe i qeverisë njëkohësisht, Edi Rama, po bën sprovat e fundit se si mund të shihen demonstratat e dhunshme.

Sidoqoftë, edhe pse nuk ka "asgjë të re në frontin e Perëndimit", të gjithë drejtuesit e partive politike përbetohen për ecjen drejt Evropës - tabloja politike do të jetë thuajse e njëjtë me atë prej dekadash.

Të njëjtët njerëz do të jenë në radhën e parë, të tjerët pas tyre dhe në fund votuesit. Tribuja politike sillet rreth fare pak emrave, të gjithë të njohur, të gjithë të provuar, të gjithë zhgënjyes. Ata do të jenë përsëri si në letrat spathi, disa me kokën lart e disa kokëpërmbysur por, të njëjtët. Asnjëri nuk ngjall shpresën e madhe që është pritur dhe të gjithë janë fatpërmbysës e jo fatsjellës. Kush më pak a kush më shumë, kjo nuk ka rëndësi. Njerëzit do të zgjedhin edhe një herë të keqen më të vogël e jo të mirën më të madhe!

Njeriu që aspiron më shumë për riciklimin e pushtetit është pretenduesi i opozitës, Lulzim

Basha. Po bëhen thuaj tetë vite në opozitë dhe durimit të tij drejt pushtetit po i vjen fundi; bashkë me të, në fundin e durimit janë edhe një grumbull i madh i figurave të politikës, të cilët nuk kanë bërë gjë për këtë vend kur ishin në pushtet dhe nuk kanë ngjallur shpresë kur ishin në opozitë.

Të gjithë figurat e opozitës së vjetër sillen rreth Lulzim Bashës dhe asnjëri prej tyre nuk është i lirë në veprimet e tij. Thuaj se të gjithë, me përjashtim të Fatmir Mediut, kanë qenë herë majtas e herë djathtas dhe përsëri, nëse i josh me pushtet, janë të gatshëm të shkojnë drejt pushtetit. Pavarësisht se kush qeveris. Nard Ndoka, Vangjel Dule, Shpëtim Idrizi, Agron Duka - herë kanë qenë me të majtën e herë me të djathtën; Monika Kryemadhi, po ashtu.

Nëse pritja dhe ethet e pushtetit para katër viteve kanë qenë të vogla, tani, pas tetë viteve në pushtet të socialistëve - që kanë edhe ata sektin e tyre pushtetar, Rilindjen, pritja është edhe më e ethshme: një traditë alternimi 8-vjeçar të pushtetit ka zënë vend më shumë në mendimin e

njerëzve: Edi Rama synon ta thyejë këtë tabu dhe anketimet e deri tanishme thonë se kjo mund të ndodhë; opozita sheh shansin e fundit të mos shpërbërjes së saj.

Nëse do të rri në pushtet Rilindja do të ndodhin tri gjëra të rëndësishme:

1. Disa nga partitë e vogla do të asfiksohen përfundimisht, ata nuk do të jenë më në skenën politike dhe drejtuesit e tyre do të përshfaqen, ashtu si janë në të vërtetë, përgjithësisht njerëz mediokër.

2. Në opozitën e tashme do të ndodhë një katarsis i pazakontë, që do të fillojë me largimin e Bashës, i cili që kur e kanë vendosur në krye të PD-së ka njohur vetëm humbje, dhe, si pritet, me ardhjen në krye të saj të një njeriu tjetër të vendosur po nga Berisha, që tani mund të jetë e familjes së tij biologjike.

3. Pas katër viteve të tjera të qeverisjes së Edi Ramës e majta do të jetë e thyer plotësisht dhe humbja që mund të ketë në vitin 2025 do të jetë edhe shkatërrimi i saj. Pas një qeverisje të Rilindjes në 12 vite,

për fat të keq, e majta do të humbë çdo vlerë të së majtës evropiane dhe do të nisë të shkrihet si simotrat e saj në kontinentin e vjetër.

Megjithatë, përplasja e vërtetë do të ndodhë mes dy figurave përdalluese, aspak joshëse: Edi Ramës dhe Lulzim Bashës.

Herën e parë ata kanë qenë përballë njëri tjetrit në zgjedhjet bashkiake të kryeqytetit, ku Basha kishte pranë vetes jo vetëm lësëistët e Metës, por edhe komunistët e Hysni Milloshit të ndjerë, votat e të cilin kthyen balancën dhe i dhanë Ramës një fitore të 10 votave, që u përmbysën nga Ristani dhe Berisha, haptas, pa droje, duke qenë thellësisht cinikë dhe duke përshfaqur, për herë të parë aq haptas, zyrtarisht, se nuk ka rëndësi se për cilin voton, e rëndësishme është se kush i numëron votat. Dhe Ristani, që e kishte provuar dorën e rëndë të Berishës, i numëroi si deshi shefi i tij, futi duart dhe rrjedhoja dihet.

Kush është njeriu që tani, për herë të tretë, pasi humbi rëndshëm në vitin 2017, edhe pse kishte gjysmën e qeverisë

dhe mori 15 milion euro për një pallat të vjehrrit, i cili duhej të ishte dënuar, do të ketë përballjen e tretë me Edi Ramën, dhe a do të jetë kjo "e treta, e vërteta", apo rënia përfundimisht e të zgjedhurit personal të Berishës, për të cilin sakrifikoi edhe Sokol Olldashin? Shumë gjëra dihen për të dhe shumë të tjera kanë mbetur enigmë. Të gjitha, ose i ka përshfaqur, ose i ka mbuluar përmes buzëqeshjes së tij.

Në Tiranë u shfaq në fillimin e vitit 2005, duke deklaruar një pasuri 1 milionë euro. Të bëra në Kosovë, ku kishte shërbyer në UNMIK. Jam i bindur se nuk ka dorë në dosjet e ngritura për drejtuesit e UÇK-së, sepse nuk kishte atë forcë dhe pozicion. Ndoshta i dallueshëm nga të tjerët, por, në fund të fundit, si ata. Ky grup i unifikasve, si debatakas, erdhën në PD. Shkuesi e bërë nga Argita Berisha, që pasi i futi të gjithë në lojë, ruajti veten.

Pasuria e tij fillestare 1 milionëshe euro është enigma e parë. Në pesë vite e fituar është pak e besueshme. I thonë të ketë kursyer 200 mijë euro në vit mesatarisht, ose të ketë një pagë mujore minimale 20 mijë euro.

Të tjerat, që lidhen me transport dosjesh, shtëpia e verdhë, video e masakrës Krushë e Madhe, aq sa mund të jenë të vërteta, aq mund të jenë edhe spekulime politike, si ndodh shpesh herë në viset shqiptare.

Në fakt, kush është njëri ndër kandidatët për kryeministër në pas 25 prillit?

Një pyetje e shtruar shumë para kohe, por si shkak për të bërë anatominë e shkurtër politike të një njeriu që nga e panjohura e madhe, sa mirë sikur të ishte vetëm kështu, kaloi drejt posteve të rëndësishme qeverisëse në të cilat, ndërsa nuk la pas asgjë për të përmendur për të mirë, la pas vetes një humbëtor të gjithanshme, me një dëmtesë të pazakonshme në jetën ekonomike e financiare të vendit, në jetën politike dhe në vetë shtetin.

Kush ia afroi Berishës 15 vite më parë, kur asnjë tjetër nuk e njihje?

Njohja mes tyre nuk ka qenë e rastësishme.

Thënia e tashme e Berishës se e kam njohur Bashën që në fillim të viteve '90-ta është po ashtu një spekulim tjetër.

I panjohuri i ardhur nga zyrat e të huajve në Kosovë, ku nuk dihej ende se kush e kishte gjetur e që më pas, do të vinte këtu përmes bekimit të Argita Berishës dhe një serbo-boshnjaku, Fazliq, nuk mund të paraqiste asnjë kredencial tjetër, veç shtatit të gjatë,

pamjes së bukur dhe miqësisë me vajzën e liderit të opozitës që shumë shpejt, sa po të bëhej kryeministër, postin më të begatshëm, do ia besonte atij. I besuar tri herë, duke përdhosur tri herë postet e tij, përmes vjedhjeve, vrasjeve dhe Marrëveshjes së Detit, ai të gjitha do i përcillte përmes një buzëqeshje karakteristike të personazheve të Dikensit.

"Njeriu që qesh" ishte thirrur thjeshtë si vajtojcat e dikurshme.

Çuditërisht, ky njeri, pa asnjë mendim të tij politik dhe pa asnjë thërrime vizioni, pa asnjë të shkuar, u bë njeriu i së ardhmes në PD-në e dhuruar dhe, nga e cila, pasi skicoi fundin politik, (të jetë vetëm kaq!) të Olldashit, fundosi edhe një plejadë, që thënë të drejtën, me ndonjë përjashtim, nuk më janë dhimbës.

Njeriu i panjohur, kamerieri i dikurshëm i Rinasit, i emëruar apo i dërguar, këtë askush nuk e di, poseduesi i një pasaporte amerikane, për të cilën askurrë nuk e tregoi se si kishte arritur tek ai, i dyshuari i dosjeve të atyre që kishin bërë luftën në Kosovë, ndihmësi i hetuesve i çështjeve përvëluese të pas luftës, njëri nga ata njerëz enigmë prej të cilëve mund të dilte do të dilte e plotë dosja e Millosheviqit, ashtu si kishte dalë më parë dosja e Ramush Haradinajt, edhe me ato që ishin thënë në korridoret e në bisedat e lira; njëri ndër të akuzuarit e krijimit e legjendës famëkeqe të Shtëpisë së Verdhë; tani do të ishte figura kryesore e opozitës, që, të paktën në një rast, tregoi se edhe brenda vathës së tij, ajo që shitet kushton më shtrenjtë se vlera që është fluide. Për të parën herë, në vitin 2017, ai i dërgoi listat e kandidatëve për deputetë të PD si në serialet turke, një pjesë sot e një tjetër nesër... sipas ligjit të kërkesës - ofertës. Të gjitha këto dihen. Ashtu si dihet se çdo lider i opozitës synon të vijë sa më shpejt në pushtet, të qeverisë. E drejtë e ligjshme, por jo kur tentohet të arrihet me çdo mjet të paligjshëm.

Nëse dikush, më herët, ka pasur dyshimin se pas Bashës qëndron një njeri që është i gatshëm të shesë kombin e tij, apo se veprimet e tij në Kosovë kanë qenë sporadike e të justifikuara nga detyra, tani, që gjërat po rrjedhin ndryshe, mund të jetë i bindur se "njeriu që qesh", i cili, sipas Topallit, "të gënjen edhe kur të thotë se sa është ora", nuk ka ardhur rastësisht në atë post dhe se miqësia e tij me Fazliqin e "kalitja" në kudhrën e hetuesisë janë saktësisht të përlogaritura. Asnjëherë tjetër, nga askush, edhe kur liderë si Nano kanë

qenë të burgosur apo si Rama, të vjedhur masivisht, nuk kanë bërë kështu kundër vendit të tyre, nuk kanë pasur këtë tërbim, deri në shtazëri ndaj një shteti ku bëjnë pjesë dhe ku rastësisht kanë lindur. Ka disa muaj, por sidomos pas dështimit të avragimit të gjendjes, kur paturpësinë e qeverisjes së Ramës nuk mund ta hedhësh tutje me numërim të vdekurish apo me mentalitetin e Petrit Vasilit, i, që Basha dhe një grup rreth tij, shumica të pavlerë brenda vendit, por të fryrë jashtë tij, po bëjnë të gjitha përpjekjet për të deleguar imazhin e një Shqipërie tjetër, krejt tjetër, e cila, edhe pse është larg asaj që njerëzit duan, nuk është ajo e Bashës.

Një sulm aspak befasues ka shpërthyer kundër çdo njeriu, institucioni dhe organizmi që, sado pak, ka interes të mbarë ndaj vendit, që synon të shpejtojë interimin e tij, dhe që, në një formë a në një tjetër, duke harruar se grupimi politik është më i pakët se sa vlera e një shteti, merr përsipër të bëjë diçka në të mbarë.

Sulmet për jetën private të ministrit të ri të Punëve të Brendshme, ishin aq banale dhe të pavlera, sa që vetëm një mendje anadollake si e Palokës apo verbësi si e Berishës mund ta ndillnin. Basha, si askush tjetër, në çdo qelizë institucionale ku ka pasur mundësi ka nisur kasnecët e tij dhe kjo nuk është bërë e nuk po bëhet falas, se ashtu ia do qejfi atyre që marrin përsipër të nxijnë këtë vend. Pagesa të mëdha, nga të cilat vetëm disa dihen e deri tani janë bërë të njohura, janë nisur drejt këtyre grupimeve për një mision të vetëm, nxirjen e një vendi që shpejt do të futet në zgjedhje politike dhe që, edhe tani, nuk e merr veten nga kjo dërrmë. Megjithëse qeveria Rama është e fajësuar për mbetjen e negociatave me BE, gëzimi i opozitës është foshnjor, pasi edhe ajo këtu jeton.

Jo vetëm firmat e ngarkuara, por edhe të hollat miliona dollarëshe, janë deri tani të pagjurmë se nga janë nisur e nga kanë vajtur. Verifikimet e deritashme në shtetin amerikan dëshmojnë vetëm për disa firma fantazmë që nisin paratë e pëdëistëve, do të thotë të njerëzve Bashës, por jo origjinën e tyre. Nëse një ditë do të ketë të dhëna të qarta se këto kanë dalë nga parajsat fiskale, kjo nuk do të jetë çudi, ashtu si nuk do të jetë e papritur se fillesa e tyre e hershme është pikërisht në lidhjet Bashës me Fazliqin, të njëjta me lidhjet që kishte dikur Berisha, në fillimet e tij, me lobin dhe strukturat e larta serbe. Fazliqi është tani

kundërshtar shpotitës i Bashës dhe i afruar me Ramën, çka nuk përbën çudi për ata që njohin politikën shqiptare. Humbjet e liderëve të opozitës së sotme në parajsat fiskale qipriote, mendimi se SPAK-u dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, një ditë do të zgjasë duart drejt pasurive të tyre, e bën gjendjen më alarmante dhe përleshjen për pushtet edhe më të pamëshirshme! Vitet në opozitë nuk e kanë pakuar pasurinë e vjedhur prej tyre, por rrugën atyre ua tregoi Fazliqi dhe njerëzit e tij, për të pasur gjithnjë brenda vetes një pjesë e atij grupimi që, edhe kur e ndjen se po mbytet, kërkon të mbysë edhe vendin e tij. Sipas parimit të njohur berishian, "pas meje, të bëhet kiameti". Nuk është vetëm etja për pushtet ajo që e shtyn një njeri të politikës, aq më tepër një shef opozite, drejt karriges kryeministrorë. Në këtë rast, është shumë më tepër se kaq. Beteja për kryeprokurorin është vetëm njëra prej tyre; shfaqja e oligarkisë financiare që mund të shkërmoqet nuk është e gjitha. Detyrime më të mëdha qëndrojnë pas gjithë këtyre përpjekjeve të pareshtura për të hedhur gjithçka në greminë, për të shfaqur para botës një shtet që, megjithëse ka dhjetëra probleme të mëdha, shumë nga të cilat të lënë prej atyre që ikën, përsëri nuk është ai që përpiqen të shfaqin.

Në takimet e fundit të Bashës me statura të njohura të politikës së mendimit të djalhtë evropian, disa nga të cilat kanë trajtuar ndryshe nga ai shtetin shqiptar, është folur me tërbim të pazakontë, janë sajuar fakte dhe ngjarje sipas "qytetarit digjital" dhe është krijuar një tablo sinoptike sipas stilit të hoxhizmit. Pas takimit të fundit me Bashën ka prej tyre që kanë ngritur çudinë dhe kanë dyshuar nëse ky njeri mban vërtet një pasaportë shqiptare. Gjuha e tij ky qenë e njëjtë me atë të diplomacisë serbe, e nganjëherë deri edhe në detaje. Si duket, pas përkthimit në gjuhën shqipe.

Është një e vërtetë e pamohueshme: në të gjithë atë që ka bërë në jetën e tij politike, pas humbjes së parë të madhe, në qershorin e vitit 2013 dhe, si nuk ishte menduar, ardhjes së tij në drejtimin e PD-së me bekimin e të parit të fisit të tij politik, Berishës, ka qenë synimi për të ardhur në krye të qeverisë sa më parë të jetë e mundur.

Është njëra nga pamundësitë e mëdha dhe për më tepër e ditur. Që të jemi të saktë deri në fund, të paktën me bindjen tonë, qeveria Rama nuk është ajo që është pritur dhe nuk ka sjellë atë që njerëzit kanë menduar. Ka njerëz të devotshëm ndaj saj që janë të zhgënjyer dhe që do të

kishin dashur të ishte në shumëçka ndryshe. Është lehtësisht e përfytyrueshme të ndjesh dëshpërimin e zhgënjimin e shumë njerëzve me politikën e mosndëshkimit të së keqes, lejimin e saj e, në jo pak raste, vazhdimin në një formë tjetër.


Arritja spektakolare e Ramës në vitin 2017 nuk ishte meritë vetëm e tij. Ai bëri lojën më të mirë të mundshme politike, duke i kthyer krahët asaj që nuk ishte bërë dhe duke sjellë në skenën butaforike kundërshtarët e tij. Vasilin, që në mendimin e shumëkujt ishte vetëm një i deleguar i zakonshëm, dhe Bashën, që nuk ia vlente. E kishin provuar tri herë ministër, një herë kryebashkiak, e kishin provuar të qeshur e të paqeshur, nuk ia vlente.

Basha kërkon të rrëzojë një qeveri që nuk është më e mira e mundshme, jo se do të mund të sjellë një tjetër. Ai e di këtë. E di faktin se askush nuk mund ta rrëzojë Ramën nga pushteti, edhe nëse lëshon nga zinxhirët të gjithë ndokët e tij. E di se asnjë shtetar i huaj, me mend në kokë, nuk mund të heqë një njeri të autoritetshëm, që jo pak herë edhe ABUZON me këtë autoritet dhe të vendosë një të bindur të politikës agresive. Një njeri që kur nuk i ecë i tija, si ato fëmijët planprishës, thërret kushërinjtë dhe i bërtasin të tjerëve, si këto thirrjet e fundit kundër ndërkombëtarëve, që e detyruan ustain e tij, Berishën, të kërkoj ndjesë, dhe që, si duket, e kanë vendosur kufirin mes tyre, shteteve që përfaqësojnë dhe një grupi me pak identitet në politikë.

Basha i di të gjitha këto. Problemi kryesor i Bashës është në pafuqinë e tij për t'u shkëputur nga berishizmi si rrymë politike dhe si praktikë përmbyse. Ai e kërkon këtë shkëputje dhe këshilltarët e tij e dinë, ashtu si edhe grupi rrethues i skifterëve. Në tetë vjet lider ai qëndroi gjatë nën vegjetimin e agresivitetit të një politike, e cila atij nuk i shkon për shtat, dhe nga e cila struktura euro-perëndimore po synojnë ta shkëputin. Do të jetë lufta më e pamundur e tij, pasi ndodhet mes një trekëndëshi rrethues: në njërin cep Berisha, që kërkon pushtet për të qenë i sigurt se nuk do të ketë ndëshkim; në cepin tjetër Ilir Meta, që e di se humbja e 25 prillit është edhe pragu i fundit të tij politik dhe, në cepin kryesor Edi Rama që kërkon vazhdimin e pushtetit që, po ashtu, të ketë kohë t'i mbyllë faktet e ndëshkimit.

Vështirë do ta ketë, në mos të pamundur!

Haraçet e borxhet e vjetra paguhen një ditë!



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Javë me plot derbi në basketboll

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 11-të në Prince Superligën e Kosovës në basketboll, ku do të ketë disa ndeshje shumë interesante. Trepça, që së fundi ka bërë ndryshime në shtabin teknik dhe te lojtarët e huaj, do të ballafaqohet me Vëllaznimin. Mitrovicasit kanë dy fitore dhe tetë humbje, kurse kuqezinjët tri fitore dhe shtatë humbje, andaj pritet një ndeshje interesante. Takim shumë interesant pritet ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Sigal Prishtinës. Therandasit kanë pesë fitore dhe pesë humbje, kurse prishtinasit tri fitore dhe shtatë humbje. Dy rivalët e vjetër, Bashkimi dhe Peja, ballafaqohen të dielën.



Prizrenasit janë në formë në ndeshjet e fundit, kurse pejanët kanë pësuar dy humbje në dy duelet e fundit. "Portokallezjinjtë" kanë pesë fitore dhe pesë humbje, kurse

"verdhezinjtë" shtatë fitore dhe tri humbje. Takimi më interesant është ndërmjet Ponte Prizrenit dhe Rahovecit, dy skuadra që janë në një seri të fitoreve, pesë, përkatësisht

gjashtë radhazi. Prizrenasit kanë shtatë fitore dhe tri humbje, kurse "vreshtarët" tetë fitore dhe dy humbje.

Josh Martin, MVP i xhiros së 10-të

Ponte Prizreni ka shënuar fitoren e pestë radhazi. Këtë herë mundi Pejën 79:93. Basketbollisti më i mirë i prizrenasve ishte Josh Martin me 23 pikë dhe 14 kërcime, me një indeks prej 33. Martin ka qenë një nga lojtarët më të dalluar të Ponte Prizrenit në këtë edicion, ku prizrenasit kanë shtatë fitore dhe tri humbje, duke u renditur në vendin e tretë me pikë të njëjta me Pejën dhe një pikë më pak

se lideri Rahoveci. Martin, gjithashtu, është një lojtar shumë atraktiv me ngulitjet e tij. Top pesë shënuesit e xhiros së dhjetë janë: Christopher Hortman i Vëllaznimit me 35 pikë, Drilon Hajrizi i Pejës me 31, Musab Mala i Bashkimit me 29, Isaiah Traylor i Rahovecit me 28 dhe Marvin Jones i Rahovecit me 24.

SUPERLIGA

Të shtunën takohen:

15:00 Trepça - Vëllaznimi

15:00 Golden Eagle Ylli - Sigal Prishtina

Të dielën takohen:

14:30 Bashkimi - Peja

17:00 Ponte Prizreni - Rahoveci

Munishi: Asnjëherë nuk do ta kuptoni pse jam ndarë me Ballkanin



SUHAREKË, 25 DHJETOR (ER) - Ish-trajneri i Ballkanit, Ismet Munishi, ka thënë se asnjëherë nuk do ta tregojë arsyen pse u shkarkua nga stoli i "Xhebrailave". Tekniku prishtinas përmes një postimi bëri me dije se nuk do ta tregojë të vërtetën pse u largua. Ai ka bërë më dije se do të jetë tifoz i Ballkanit deri në fund të këtij edicioni. "Unë jam Ismet Munishi. As fjalën time as heshtjen nuk mund të blejë askush. (Siç pretendohet nga gazetarët dhe portalet e

ndryshme, të cilët kurrë nuk në të vërtetë do ta kuptojnë pse jam ndarë me FC Ballkanin). Deri në fund të edicionit do të jem tifoz me FC Ballkanin me Arsim Kabashin me 'Xhebrailat' dhe futbollistët fantastikë që punova me shumë djersë me ta. Çdo tendencë që flasin dhe shkruajnë ndryshe gazetarët, portalet dhe mjetet e informimit, e cilësoj manipulim, devijim, sulm tejet tendencioz kundër meje, klubit tim dhe presidentit tim. Deri në fund të edicionit do të jem analist, në

cilin televizion nuk di, sepse do t'i shohim projektet dhe do t'i analizojmë ofertat. Do ta jap kontributin ndryshe. Kampion është ai që nuk dorëzohet kurrë", ka shkruar Munishi në profilin e vet në "Facebook". Munishi është shkarkuar ditë më parë nga posti i trajnerit në klubin e Ballkanit, me të cilin punoi për një vit e gjysmë. Edicionin e kaluar Ballkani arriti deri në finale të Kupës, kurse këtë edicion shfaqti lojërë të mira, por sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e dytë.

'SportBild': Bie interesimi për transferimin e Rashicës

BREMEN, 25 DHJETOR - Reprzentuesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, mund të largohet nga Werder Bremeni në afatin kalimtar të janarit.

"SportBild" në Gjermani raporton se interesimi për transferimin e Milot Rashicës ka rënë dukshëm, pasi futbollisti "dardan" është përballur kohën

e fundit me lëndime. Rashica ka dhuruar vetëm një asistim këtë edicion, andaj vlera e tij në treg ka rënë nga 28 në 18 milionë euro.



Lorik Aliu i jep fund karrierës si futbollist

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Një lajm aspak i mirë për adhuruesit e futbollit në Kosovës ka ardhur të premten nga futbollisti Lorik Aliu, i cili ka deklaruar se do t'i varë atletet në gozhdë. Një nga talentet më të mëdhenj e mori një vendim të tillë, pas shumë

lëndimeve që e përcollën në karrierën futbollistike. "Po shfrytëzoj këtë postim për t'ju dhënë një lajm jo të mirë për mua dhe të gjithë ata që më projektuan në majat e sportit më të bukur, futbollit. Kam vendosur që përfundimisht t'i jap fund

karrierës sime si futbollist aktiv për shkak të lëndimeve të shumta duke e cilësuar si vendimin më të drejtë. Është tejet e vështirë t'i vendos atletet në gozhdë, pasi ëndrra më e madhe e jetës time u ndërpre dhe u shua shumë shpejt", ka shkruar Aliu në

profilin e vet në "Facebook". "Ëndrra për t'u bërë futbollist profesionist i nivelit të lartë, do të ngelet në sirtarin tim, si e përealizuar përjetësisht. Dua t'ju falënderoj të gjithëve që më qëndruat afër nga dita e parë e deri sot", ka shtuar Aliu.




Cormier: Paratë nuk mjaftojnë për të rikthyer në kafaz Khabibin

Makhachkala, 25 dhjetor - Presidenti i UFC-së, Dana White dhe rusi Khabib Nurmagomedov, kanë deklaruar se shpejt do të takohen për të diskutuar për të ardhmen e kampionit të

peshës së lehtë. Pavarësisht se Khabib deklaroi largimin e tij nga sporti, ai ende e mban titullin e këtij Divizionit. Sipas ish-kampionit të botës, Daniel Cormier, mikut të ngushtë të Nurmagomedov dhe një prej

personave që e njeh më mirë rusin, presidentit të UFC-së i duhet një arsye e mirë që të bindë Khabib të rikthehet në kafaz. Sipas Cormierit, shuma prej 100 milionë dollarësh që ka deklaruar Khabibi nuk do të

mjaftojë. "Kam pyetur një herë Khabibi se sa para duhen të jesh i pasur në Dagestan. Ai më ka thënë se mjaftojnë pesë milionë për të qenë i pasur tërë jetën. Këtë shumë ai e ka arritur prej kohësh, ndaj Dana



White i duhet një argument i fortë për të bindur Khabib të rikthehet në kafaz", ka deklaruar Cormier.

Bordi i Shoqatës së Trajnerëve: Ka ngritje të cilësisë në futbollin e Kosovës

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Bordi i Shoqatës së Trajnerëve të Futbollit e ka mbajtur të premtën takimin e fundit për këtë vit. Gjatë kësaj mbledhje u diskutuan shumë çështje që kanë të bëjnë me shoqatën dhe trajnerët e Kosovës, por edhe për futbollin në përgjithësi. Me këtë rast Bordi i Shoqatës së Trajnerëve vlerësoi se viti 2020 ka qenë tejet i vështirë, duke e pasur parasysh pandeminë Covid-19, gjë e cila ka ndikuar edhe në aktivitetin e shoqatës. "Duke e analizuar rrjedhën e garave të stinorit vjeshtor Bordi i Shoqatës së Trajnerëve vlerësoi se është shënuar një ngritje e cilësisë në futbollin tonë, kurse formatin e Superligës me 10 skuadra e ka cilësuar si të qëlluar dhe që ka pasur ndikim në organizimin e klubeve dhe në cilësi të ligës", thuhet në njoftimin e FFK-së. Po ashtu, edhe formati i garave në Ligën e Parë dhe në Ligën e Dytë



u vlerësua që ka pasur ndikim pozitiv dhe përkundër orarit të ngjeshur skuadrat kanë arritur të tregojnë formë të mirë. Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për licencimin e trajnerëve dhe vazhdimin e licencave B dhe A. Bordi i Shoqatës së Trajnerëve

shpreson se në vitin 2021 rrethanat do të jenë më të mira dhe do të ketë mundësi për më shumë aktivitete të trajnerëve, siç janë seminarët dhe trajnimet e ndryshme me emra të njohur të futbollit vendor dhe ndërkombëtar.

Media italiane për Muriqin: Katastrofë, nuk e kap dot trenin

ROMË, 25 DHJETOR - Shansi i artë që trajneri Simone Inzaghi i ka dhënë sulmuesit Vedat Muriqin në ndeshjen kundër Milanit, atje ku luajti më tepër sesa 45 minuta pas dëmtimit të Correas, rezultoi me efektin e kundërt për sulmuesin shqiptar. Mungesa e golit të parë në Seria A, fakti se nuk arriti të rrezikonte kurrë portën e kuqezinjve dhe e bashkuar me humbjen e Lazios në transfertë, sollën gjithë irritimin e tifozëve. Të gjithë flisnin se 20 milionë eurot që u investuan për Muriqin janë të hedhura dëm. Të paktën duke parë deri tani statistikat e ofruara nga ky sulmues. Së fundmi është "Cittaceleste" që jep një përshkrim mes shumë figurave letrare, por duke paraqitur saktësisht situatën e futbollistit të Kosovës. "Paraqitja ndaj Milanit ishte skandaloze dhe Muriqi nuk arriti të kapte trenin për të mbërritur në destinacion. Pra shansi më i mirë, që nuk u arrit të shfrytëzohej. Por një tjetër mundësi do të vijë dhe sulmuesi duhet ta kap për t'i treguar të gjithëve se kanë gabuar. 'Bëhu gati, do të hysh



në fushë'. Kjo është fraza që çdo futbollist do të donte që ta dëgjonte në karrierë. Sidomos nëse vjen nga larg dhe ke mbërritur në një nga kampionatet më të njohura dhe më të vështira në botë. Treni kalon për të gjithë, t'i duhet ta kapësh dhe të arrish në destinacionin tënd në mënyrën më të mirë të mundshme. Por 'pirati' Muriqi është i mësuar që të lundrojë në det më mirë sesa të kap trenat që lëvizin. E ka humbur rastin e tij. Inzaghi e ka preferuar Muriqin, duke lënë jashtë Felipe Caicedon, një lojtar që u kthye si një lloj hyjnie

në botën e Lazios. Por ajo që ofroi Vedati nuk ishte fare e pranueshme. I ngadaltë, i rëndë në ecje dhe vështirësi që hasi gjatë takimit. Fuqia fizike? Është aty, por lehtësisht i parashikueshëm. Me pak fjalë katastrofë. COVIDI, dëmtimet, janë një alibi që mund të shkojnë deri diku, por jo kur sheh vlerën e parave të investuara për të. Në një sezon të lodhshëm dhe të gjatë: 'Bëhu gati, se do të hysh në ndeshje', do të jetë një frazë që do të dëgjohet prapë. Por këtë herë Muriqi duhet të kap trenin", shkruhet në artikull.

SHKURT

Arbëria prezanton Santosin

KF Arbëria e ka prezantuar transferin e dytë, Marclei Cezar-Santos. Futbollisti brazilian edicionin e fundit mbrojti ngjyrat e skuadrës së Feronikelit. "KF Arbëria i uron mirëseardhje në familjen tonë futbollistit brazilian Marclei Cezar-Santos. Së fundi ai ishte pjesë e KF Feronikeli dhe iu bashkua klubit tonë në afatin kalimtar të janarit. Santos vjen me një përvojë të madhe dhe luan në pozitën e qendërsulmuesit. KF Arbëria i dëshiron sukses dhe shëndet, duke uruar ta bëjë më të mirën e tij", thuhet në njoftimin e KF Arbëria.

Covidi prek dy yjet e Cityt

Manchester City ka konfirmuar se sulmuesi Gabriel Jesus dhe mbrojtësi Kyle Walker kanë rezultuar pozitivë pas testeve të fundit për Covid-19. Futbollistët menjëherë janë vetizuar dhe do të qëndrojnë në shtëpitë e tyre për së paku dy javë. Ata do të mungojnë në ndeshjen e nesërme që Manchester City do ta zhvillojë me Newcastle Unitedin. Teste do të ketë sërish, për ta parë gjendjen e futbollistëve të tjerë.

Nadali: Viti 2020, më i vështiri në karrierën time

Gjatë këtij viti Rafael Nadal arriti fitoren numër 1 000 në karrierën e tij si profesionist. Gjithashtu, ai arriti të triumfojë për të 13-n herë në grand slam të Roland Garros. Pavarësisht kësaj, tenisti spanjoll shprehet se ky vit nuk ka qenë i lehtë për të. "Po i japim lamtumirën një viti që është më mirë ta harrojmë. Mbetet viti më i ndërlikuar që kemi jetuar ndonjëherë, viti im më i vështirë", ka thënë Nadal. "Uroj që gjërat të përmirësohen vitin tjetër. Kam shumë projekte që i kam shtyrë për vitin 2021. Shpresoj që vaksina të përhapet sa më shpejt kudo në botë dhe t'i rikthehem jetës së mëparshme", ka shtuar spanjollli.

Mbappe: Tucheli shkroi historinë me PSG-në

Sulmuesi Kylian Mbappe e ka falënderuar tanimë ish-trajnerin e tij, Thomas Tuchel, duke thënë se ka shkruar histori me klubin dhe nuk do t'i harrojë çastet që i kanë kaluar së bashku. 47-vjeçari ka fituar 6 trofe me klubin parisien dhe e ka udhëhequr PSG-në deri në finale të Ligës së Kampionëve sezonin e kaluar, mirëpo kjo nuk mjaftoi që ai të qëndrojë në stolin e Parkut të Princave. Mbappe ka postuar një foto në rrjetin social "Instagram", me mbishkrimin: "Fatkeqësisht është një rregull i futbollit". Gjithashtu, duke i thënë Tuchelit se do ta kujtojë gjithmonë atë. "Ju keni shkruar një histori të mrekullueshme në këtë klub dhe dua t'ju falënderoj juve", u shpreh francezi.

Atletico në garë për Calhanogun

Çështja më e nxehtë në Milano është kontrata Hakan Calhanoglu. Turku dhe Milani përfundojnë bashkëpunimin në verën e ardhshme dhe rinovimi nuk ka ardhur deri më tani, madje nga ajo që raportohet pritet të mos vijë. Oferta e Milanit për mesfushorin është 3.5 milionë euro në sezon, teksa ai kërkon dyfishimin e kësaj shume. Në këto kushte Milani mund të mendojë ta shesë që në janar dhe kandidatët për të blerë turkun dalin menjëherë në skenë. Mësohet se Atletico Madridi është gati ta propozojë pagën e kërkuar nga Calhanoglu si dhe të ofrojë një shifër të arsyeshme për Milanin, në mënyrë që mesfushori të zbarkojë në Madrid në merkaton e dimrit. Manchester Unitedi është gjithashtu kandidat potencial për të arritur te 26-vjeçari.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti


AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë



Thirrje për Aplikim

ABI ABIJA SH.P.K- Arberije Ramush Agushi, me NRUI: 811411347
Adresa: P.N, P.N-Drenoc, Klinë

Kërkon një ofertues/ kompani të interesuar dhe të kualifikuar-Licencuar që të dorëzojë ofertë për projektin me titull:

“Ngritjen e pemishtes në sipërfaqe prej 10 ha të kombinuara, me 6 ha Arra, 2 ha Kumbulla dhe 2 ha Mollë, me fidane të importuara nga vendet e BE-së, me infrastrukturë përcjellëse”.

Pozicionet që do të realizohen nga kjo thirrje janë si në vijim:

Fidane- Arre, 1800 copë.

Fidane- Mollë, 4200copë.

Fidane-Kumbull, 1600 copë.

Hapja e gropave dhe mbjellja e fidanëve.

Vendosja e rrethojës, për komplet sipërfaqen prej 10 ha.

Mbajtëse për fidanë -420 copë.

Sistemi i ujitjes pikë pikë/ komplet për 10 ha.

Punë nga pala e tretë për vendosje të sistemit pikë pikë.

Ngritja/investimi në ngritjen e punishtes prej 10 ha, siç është cekur më lartë do të bëhet në fshatin Pjeteriq i Epërm- komuna e Klinës.

Kompanitë e interesuara mund të kontaktojnë në e-mail: arberije.aa@hotmail.com ose përmes formës fizike me zarf dhe shprehja e interesit të bëhet në adresën e lartë cekur duhet të bëhet më së largu pesë (5) ditë nga data e shpalljes.

Kompanitë e interesuara, do të marrin specifikacionin dhe do të ftohen për ofertë financiare.

Kriteret e përzgjedhjes, oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët.

Për çdo sqarim dhe info kontaktoni:

Tel: 049-165-125

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Kofix” Sh.p.k. Kmetofc, Gjilan, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatin e gurit gëlqeror në Koretishtë, Novobërdë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.01.2021 në ora 11:00 në hapësirat e restorant “Gersheta” në Stanishor komuna e Novobërdës do të organizohet debat publik nga kompania “Kofix” Sh.p.k. Kmetofc, Gjilan, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatin e gurit gëlqeror në Koretishtë, Novobërdë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

[https://us04web.zoom.us/j/3641684670?](https://us04web.zoom.us/j/3641684670?pwd=YzRTQjJnSGpzZVlqTmhtUGNnK29mZz09)

[pwd=YzRTQjJnSGpzZVlqTmhtUGNnK29mZz09](https://us04web.zoom.us/j/3641684670?pwd=YzRTQjJnSGpzZVlqTmhtUGNnK29mZz09)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

**Gjeje PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► “Dardania Post” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810067729.

► “Koci-Gallery” B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70398092 si dhe me nr. fis. 600027636.

► N.Sh.T ADAM & EVA B.I. shpall të pavlefshëm certifikatën e numrit të biznesit: 70629011, të lëshuar në Prishtinë.

► Adelina Xharrahu, e diplomuar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, shpall të pavlefshme diplomën e studimeve bachelor.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoh një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

